

Vendim nr. 163 datë 16.07.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Sonila Bejtja,	Anëtare
Genti Ibrahimimi,	Anëtar

në datën 16.07.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 20 (A) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: ALESSANDRO LOCATELLI, përfaqësuar nga avokat Bardhi Koçi.

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor nga vendimet nr. 986, datë 16.07.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 42, datë 17.01.2018 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe nr. 2152, datë 12.12.2023 të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 43, 122, pika 2, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 27, 28, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 04.04.2012 ka urdhëruar që në regjistrin e veprave penale të regjistrohet emri i të pandehurit Alessandro Locatelli (kërkuesi) shtetas italian dhe shtetasit P.G, si të dyshuar për kryerjen e veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 287, paragrafi 2, shkronja “b”, i Kodit Penal (KP) dhe në datën 18.06.2012 ka marrë vendimin “Për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës për të pandehurit Alessandro Locatelli dhe shtetasit P.G”. Në përfundim të hetimeve paraprake, në datën 29.06.2012 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë kërkesën për gjykimin e dy të pandehurve me akuzën “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 287, paragrafi 2, shkronja “b”, i KP-së.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 27.03.2012 ka vendosur veçimin e çështjes për kërkuesin dhe dorëzimin e saj në sekretari për t’u hedhur në short. Gjykimi i çështjes për kërkuesin është zhvilluar në mungesë të tij, pasi nuk është gjendur në adresën e paraqitur nga prokuroria në seancë gjyqësore. Nga ana e Gjykatës është caktuar një avokate kryesisht, e cila ka marrë pjesë në hetimet paraprake.

3. Kërkuesi në datat 04.03.2010 dhe 05.03.2010 ka kryer dy transferta drejt Shqipërisë nga Sllovenia, në total shumën prej 500.000 eurosh, e cila është sekuestruar menjëherë pas regjistrimit dhe fillimit të hetimeve për këtë çështje penale. Sipas deklaratave të tij në bankën sllovene, në momentin e transfertave, kjo shumë vinte nga shitja e një zinxhiri dyqanesh ushqimore në Gjermani, që do të thotë se në këtë moment ishte një burim i deklaruar i ligjshëm. Nga hetimet e kryera ka rezultuar se i pandehuri Alessandro Locatelli në bashkëpunim me të pandehurin P.G. kanë kryer fshehjen ose mbulimin e natyrës së vërtetë të burimit, të pasurisë produkt të veprës ose të veprave penale, veprim i cili parashikohet nga ligji shqiptar si vepër penale dhe konkretisht “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 287 paragrafi 2, shkronja “b”, i KP-së.

4. Në vijim, Zyra Qendrore Kombëtare Interpol Tirana dhe autoritetet italiane kanë konfirmuar se kërkuesi është i përfshirë në këto transaksione që janë produkt i veprimtarisë kriminale dhe rezulton të jetë i dënuar për vepra penale në shtetin italian për një sërë krimesh në fushën financiare. Po ashtu, edhe nga letërporosia e administruar në seancën gjyqësore, autoritetet

gjermane kanë informuar se për kërkuesin nuk ka informacion në Gjermani, si dhe është provuar se ai nuk ka poseduar ndonjë pasuri në shtetin gjerman.

5. Me vendimin nr. 986, datë 16.07.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur deklarinim fajtor të të pandehurit Alessandro Locatelli për kryerjen e veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale”, në bashkëpunim dhe në bazë të nenit 287, paragrafi 2, shkronja “b”, të KP-së e ka dënuar me 7 vjet burgim. Vuajta e dënimit fillonte nga dita e ekzekutimit të këtij vendimi dhe do të kryhej në një burg të sigurisë së zakonshme. Po ashtu, bazuar në nenin 275/2 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) ka vendosur konfiskimin e shumës së vendosur nën sekuestro preventive prej 500000 eurosh, e cila rezulton produkt i veprave penale ose veprimtarisë kriminale të kryer nga të pandehurit dhe kalimin e saj në favor të shtetit.

6. Me vendimin nr. 548, datë 14.07.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rivendosjen në afat të së drejtës për të ushtruar ankim të kërkuesit në gjykatën e apelit. Pas rivendosjes në afat të ankimit, avokati i zgjedhur nga kërkuesi ka ushtruar ankim, duke kërkuar ndryshimin e vendimit nr. 986, datë 16.07.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe deklarinim e tij të pafajshëm për akuzën që i atribuohet.

7. Me vendimin 42, datë 17.01.2018, Gjykata e Apelit Tiranë ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke arsyetuar se vendimi është rezultat i një analize të hollësishme të provave të nënshtruara shqyrtimit gjyqësor të çështjes, prova këto të vlerësuara sipas parashikimeve të nenit 152 të KPP-së, të cilat kanë provuar tej çdo dyshimi fajësinë e të pandehurit në kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 287, paragrafi 2, shkronja “b”, i KP-së. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesi, duke kërkuar prishjen e vendimit të gjykatës së rrethit dhe atij të gjykatës së apelit, si dhe kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me tjetër trup gjykues.

8. Me vendimin nr. 00-2023-2152, datë 12.12.2023, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, duke vlerësuar se vendimi objekt rekursi është rrjedhojë e zbatimit të drejtë të ligjit procedural dhe material penal, si dhe nuk rezulton që vendimet e ankimuar të jenë në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

9. Në datën 27.05.2024 kërkuesi, përmes përfaqësuesve të tij, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 13.05.2024.

II

Pretendimet e kërkuetit

10. **Kërkueti**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se gjatë procesit gjyqësor të kundërshtuar i është cenuar e drejta për proces të rregullt në drejtim të *së drejtës së aksesit, së drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur*, pasi vendimi i Kolegjit Penal është marrë në dhomën e këshillimit pa praninë e palëve, edhe pse çështja ishte komplekse. Gjykata e Lartë ka gabuar, pasi me ndryshimet e KPP-së ajo i shqyrton çështjet vetëm për shkelje të dispozitave procedurale gjatë procesit të zhvilluar në gjykatat më të ulëta dhe pa shqyrtuar provat. Gjykata e Lartë duhej t'i njoftonte palët për të qenë të pranishme në seancën gjyqësore dhe t'u kërkonte atyre shkeljet e pretenduara nga gjykatat e faktit dhe jo ta shqyrtonte çështjen në dhomën e këshillimit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuetit

11. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë kumulative, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkueti të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

12. Kolegji vlerëson se kërkueti, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor në të cilin janë dhënë vendimet e kundërshtuara, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

13. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, kërkueti i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues

individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta.

14. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga Gjykata kur kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit. Gjykata ka theksuar se vënia në dispozicion të palëve e vendimeve të gjykatës ua bën të njohura atyre arsyet e vendimmarrjes, duke u dhënë mundësinë të ankohen nëse e shohin të arsyeshme. Për rrjedhojë, si datë e fillimit të afatit ligjor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, që i korrespondon momentit të konstatimit të cenimit, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, është data e marrjes dijeni efektivisht për vendimin gjyqësor të marrë në ushtrim të mjetit të fundit ankimor. Si rregull, kjo datë është ajo e shpalljes së vendimit gjyqësor të arsyetuar në prani të palës, kurse kur vendimi gjyqësor nuk shpallet i arsyetuar ose kur pala nuk është e pranishme, data e marrjes dijeni konsiderohet ajo e njoftimit shkresor ose elektronik të tij. Në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në rastin konkret, Kolegji vëren se vendimi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesi, ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, mban datën 12.12.2023, kurse kërkesa është paraqitur në Gjykatë më 13.05.2024. Për qëllime të këtij shqyrtimi i është kërkuar informacion Gjykatës së Lartë në lidhje me momentin në të cilin ky vendim është bërë i disponueshëm për palët. Me informacionin e datës 26.06.2024, Gjykata e Lartë ka sqaruar se vendimi i saj nr. 00-2023-2152, datë 12.12.2023 është publikuar në faqen zyrtare të saj në datën 21.02.2024, datë nga e cila është bërë i disponueshëm për palët. Duke iu referuar këtij momenti, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual është paraqitur brenda afatit 4-mujor.

16. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, pretendimi i kërkuesit se i është cenuar e drejta për proces të rregullt në drejtim të së drejtës së aksesit, së drejtës për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur, pasi vendimi i Kolegjit Penal është marrë në dhomën e këshillimit pa praninë e palëve, është i tillë që bën pjesë në juridiksionin kushtetues, ndaj do të shqyrtohet në vijim.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit, së drejtës për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur

17. Kërkuesi ka pretenduar se gjatë procesit gjyqësor të kundërshtuar i është cenuar e drejta për proces të rregullt në drejtim të së drejtës së aksesit, së drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, pasi vendimi i Kolegjit Penal është marrë në dhomën e këshillimit pa praninë e palëve, edhe pse çështja ishte komplekse. Gjykata e Lartë ka gabuar, pasi me ndryshimet e KPP-së ajo i shqyrton çështjet vetëm për shkelje të dispozitave procedurale gjatë procesit të zhvilluar në gjykatat më të ulëta dhe pa shqyrtuar provat. Gjykata e Lartë duhej t'i njoftonte palët për të qenë të pranishme në seancën gjyqësore dhe t'u kërkonte atyre shkeljet e pretenduara nga gjykatat e faktit dhe jo ta shqyrtonte çështjen në dhomën e këshillimit.

18. Në nenin 42, pika 2, të Kushtetutës parashikohet se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. Ajo u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik (*shih vendimet nr. 52, datë 14.11.2014; nr. 6, datë 26.02.2013; nr. 4, datë 23.02.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, Gjykata ka theksuar se e drejta e palëve për të qenë të pranishme, për t'u mbrojtur e për t'u dëgjuar në procesin gjyqësor janë aspekte të rëndësishme të procesit të rregullt në kuptimin kushtetues. E drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk duhet konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve t'u garantohet thjesht prania fizike gjatë procesit civil, por duhet që legjislacioni procedural, në radhë të parë, dhe më pas gjyqtari gjatë gjykimit t'u japin mundësi të barabarta palëve për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare (*shih vendimet nr. 43, datë 27.12.2022; nr. 8, datë 23.02.2021; nr. 37, datë 30.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, Gjykata, në mënyrë konstante, ka pohuar se shqyrtimi i çështjes nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit nuk është vetëm një konstatim formal i paraqitjes së shkaqeve ligjore në rekurs, por konsiston në vlerësimin e këtyre shkaqeve dhe bazueshmërisë së tyre, duke analizuar materialet e dosjes gjyqësore. Nëse Kolegji në dhomën e këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs janë haptazi të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në ato që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore. Kjo është edhe përgjigjja që Gjykata e Lartë u jep pretendimeve të ngritura në rekurs nga palët (*shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 8, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Duke iu rikthyer rastit konkret, Kolegji vëren se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje mbi bazën e rekursit të paraqitur nga kërkuesi, i cili ka kërkuar ndryshimin e vendimeve të gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të apelit. Kolegji Penal, pasi ka marrë në shqyrtim rekursin, i ka dhënë përgjigje kërkuesit se në të nuk është ngritur asnjë shkak ligjor për cenimin e vendimeve të gjykatave të faktit, nga ato të parashikuara nga neni 432 i KPP-së. Nga tërësia e fakteve të vlerësuara si të provuara nga gjykatat më të ulëta, Kolegji vlerëson se ato, si gjykata të gjykimit të faktit, kanë kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes, duke administruar dhe çmuar të gjitha provat që i janë nënshtruar atij gjykimi, të zhvilluar sipas procedurës së gjykimit të zakonshëm. Ndryshe nga sa pretendohet në recurs, ky Kolegj vlerëson se vendimi objekt rekursi është rrjedhojë e zbatimit të drejtë të ligjit procedural dhe material penal, nuk ka mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit material ose procedural, me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave, të tillë që të ndikojë në dhënien e vendimit, në dëm të të gjykuarit, si dhe nuk rezulton që vendimet e ankimuar të jenë në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (*shih paragrafët 29-31 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

20. Referuar dispozitave që rregullojnë rekursin në Gjykatën e Lartë, shqyrtimi në këtë gjykatë kalon në një ose në dy faza. Në fazën e parë, që njihet dhe si faza seleksionuese, neni 433 i KPP-së parashikon shqyrtimin e rekursit në lidhje me kushtet e pranueshmërisë në dhomën e këshillimit, ku në mungesë të ekzistencës të të cilave Gjykata e Lartë disponon për mospranimin e tij, duke i dhënë kështu fund shqyrtimit. Ndërkohë, në rastin kur rekursi plotëson kushtet e pranueshmërisë, në fazën e dytë çështja shqyrtohet në seancë gjyqësore, si rregull, në dhomën e këshillimit mbi bazë të dokumenteve (neni 436/a i KPP-së) (*shih vendimin nr. 4, datë 31.01.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Për sa më lart, Kolegji çmon të theksojë se forma e gjykimit “*në dhomë këshillimi pa pjesëmarrjen e palëve*” nuk ka ndikuar në të drejtën e kërkuesit për t’u dëgjuar dhe të drejtën për t’u mbrojtur, për sa kohë ai i ka ushtruar lirisht ato nëpërmjet paraqitjes së rekursit. Në këtë kuptim, Kolegji evidenton se edhe vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i marrë në dhomën e këshillimit, nuk i cenon këto të drejta kushtetuese, pasi është në diskrecionin e tij të vendosë nëse çështja do të shqyrtohet në seancë gjyqësore me praninë e palëve ose në dhomën e këshillimit. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se vetëm fakti që rekursi është shqyrtuar në dhomën e këshillimit nuk është i tillë që të vërë në dyshim respektimin e së drejtës për proces të rregullt, për sa kohë që Kolegji Penal ka vepruar në përputhje me kompetencat e tij dhe me rregullat procedurale që gjejnë

zbatim gjatë kësaj faze të shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë. Për këto arsye, pretendimet e kërkesit për cenimin e së drejtës së aksesit, së drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur janë haptazi të pabazuara.

22. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.